



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:271233

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05873682

KPPP.nr.2099/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Rexha” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 703284474 me adresë në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arber Fazliu avokat nga Prishtina, kundër debitorit “NB Company” SH.P.K., me numër unik identifikues 70781980 me adresë në fashatin Llazarevë Komuna e Obliliqit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore.401/2023 të datës 16.10.2023 të Përmbareuesit Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “NB Company” SH.P.K., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr.401/2023 i datës 16.10.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Driton Govori, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Rexha” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrit Përmbaremore P.nr.401/2023 të datës 16.10.2023 me të cilin e ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr.2-225-001-23 të datës 24.07.2023 me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 24,323.80€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës së përmbareimit përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe regjistrohet, konfiskohet dhe shitet pasuria e debitorit si në sende të luajtshme po ashtu edhe paluajtshme të tjera në tërë masën pasurore të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se fatura mbi bazën e së cilës është iniciuar kjo procedurë përmbarimore nuk është pranuar asnjëherë në mënyrë të rregullt nga debitori si dhe të njëjtës i mungon nënshkrimi i debitorit si dëshmi e pranimit, madje ka shtuar se propozimit nuk i është bashkangjitur ndonjë kontratë përmes të cilës do të vërtetohej raporti kontraktual. Andaj mbi pretendimin se fatura e cila është objekt i kësaj procedure të përmbarimit nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta pranoj si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbarimor. Debitori ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Kreditore brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim përmes të cilës ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke i bashkangjitur edhe provat si ditari i ndërtimit si dhe ka propozuar dëgjimin e dëshmitarëve. Më tej ka theksuar se debitori ka për qëllim prolongimin e procedurës dhe se Urdhri Përmbarimor P.nr.401/2023 i datës 16.10.2023 është nxjerr në bazë të dokumentit të besueshëm dhe si i tillë është i drejtë, andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar*

kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.
Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.*

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.401/2023 i datës 16.10.2023 bazohet në Faturën me nr.2-225-001-23 të datës 24.07.2023 në lartësi prej 24,323.80€, e cila nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se fatura në rastin konkret nuk është pranuar me rregull nga ana e debitorit.

Sipas vlerësimit të gjykatës nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, pasi që në faturën e bashkëngjiturë në shkresat e lëndës mungon nënshkrimi dhe vula e debitorit si dëshmi e pranimi të saj. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur dhe kreditori nuk ka dëshmuar se në ndonjë mënyrë tjetër i ka dërguar me rregull faturën debitorit, e njëjta në procedurë përmbarimore nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Ndonëse si pjesë e shkresave të lëndës ishte edhe ditari i ndërtimit dhe foto të realizuara gjatë punimeve, gjykata në procedurë përmbarimore i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:271233
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05873682

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr. 2099/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.